



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
DREJTORIA E ARSIMIT - UPRAVA ZA OBRAZOVANJE



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti-na

Pranuar - Primitjeno		Me/Dana: 24.08.2020	
Nr i organit broj Organa	Numri-Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
05-	333/20		-

Duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë që ka, në menaxhimin dhe udhëheqjen e arsimit, drejtorëve të shkollave, personelin arsimor dhe nxënësit, si dhe duke pasur parasysh prezencën e Pandemisë KOVID-19. Drejtori i Drejtorisë për Arsim i Komunës së Vitisë më dt. 24.08.2020 miraton këtë :

URDHËRESË

I

Urdhërohen të gjithë drejtorët e shkollave Filllore-Mesme të Komunës së Vitisë, që të shtojnë angazhimin dhe përkujdesin për shkak të Pandemisë COVID-19, duke monitoruar dhe kontrolluar në zbatimin e masave mbrojtëse kundër KOVID-19, duke ruajtur distancën fizike dhe zbatimin e masave mbrojtëse maskave dhe përdorimin e preparateve dezinfektuese.

II

Urdhërohen të gjithë drejtorët e shkollave të Komunës së Vitisë, që të kenë kujdes si masë preventive në parandalimin dhe ruajtjen e distancës në mesë nxënësve, personelit arsimor dhe prindëve. Poashtu urdhërohen drejtorët e shkollave që ti angazhojnë punëtorët teknik-rojet e shkollave, që të jenë prezent në hyrje të shkollave (gjatë periudhës së regjistrimit të nxënësve) që të mos lejojnë prindërit e nxënësve që regjistrohen në shkolla të hyjnë mbenda objekteve shkollore, duke përjashtuar prindërit e nxënësve me nevoja të veçanta, të cilët kanë nevojë për prezencën e prindit.

III

Për zbatimin e kësaj urdhërese do të kujdeset Drejtoria Komunale për Arsim në Viti dhe drejtorët e shkollave filllore-mesme të Komunës së Vitisë.

IV

Kjo urdhëresë hynë në fuqi ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga Drejtori i Drejtorisë për Arsim i Komunës së Vitisë.

V

Kjo Urdhëresë mbetet në fuqi deri në miratimin-nxjerrjen e ndonjë urdhërese tjetër nga ana e drejtorisë së arsimit të Komunës së Vitisë.

Urdhëresa u dërgohet:

- Drejtorëve të shkollave,
- arkivit.

Viti, më: 24.08.2020

